

## Komuna e Podujevës/Podujevo

### **Nebojša (Čedomir) Cvejić**

(16.07.1964, serb nga Prishtina/Priština, një fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Nebojša ka qenë biolog i diplomuar. Në vitin 1991, u punësua në Sigurimin Shtetëror në Prishtinë/Priština, ndërkaq nga viti 1994 punonte në Podujevë/Podujevo. Jetonte me bashkëshorten dhe prindërit në Prishtinë/Priština. Udhëtonte për ditë në punë në Podujevë/Podujevo. Në datën **19.02.1998**, rreth orës 15:30, ai me makinën e vet po kthehej nga puna. Me të në makinë ishte edhe një koleg i tij. Përderisa ishin duke kaluar nëpër fshatin **Lupç i Poshtëm/Donje Ljupçe**, dikush ka shtënë mbi ta. Nebojšën e kanë qëlluar në kokë dhe në stomak. Gjeti vdekjen në vend. E kanë varrosur një ditë më vonë, më 20.02.1998, në varrezat e qytetit në Prishtinë/Priština.

**Burimet:** deklarata G.C, FDH-25797; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 73; SMIP, *Teroristički...*, III, 932; Z. Stijović, *Kosmet...*, 104.

### **Milić (Radivoje) Jović**

(1.05.1947, serb nga Podujeva/Podujevo, një fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Milići e kishte të mbaruar fakultetin juridik. Punonte si inspektor në Sigurimin Shtetëror në **Podujevë/Podujevo**. Shpesh e kërcënonin. Në muajin gusht të vitit 1997, sulmues të panjohur kanë shtënë mbi të, duke e plagosur. Në mëngjes, më **21.12.1998**, u nis në punë së bashku me Milijana Pantić, e cila punonte në komunë. Afro 100 metra larg banesës së tij, në udhëkryqin e rrugëve *Milo Popović* dhe

*Vožd Karadorde*, përballë Shtëpisë së Shëndetit, dy djelmosha kanë shtënë ndaj tij. E kanë qëlluar Milićin me shtatë plumba. Ka mbetur i vdekur në vend, përderisa Milijana vetëm u plagos. Milićin e kanë varrosur një ditë më vonë në varrezat e qytetit të Podujevës/Podujevo.

**Burimet:** deklarata M.J, FDH-27801; Instituti për Mjekësinë Ligjore, Prishtinë, Konstatimi mjekësor për shkaqet e vdekjes, Milić Jović, 22.12.1998, FDH-15307; SMIP, *Teroristički...*, III, 581, IV, 942; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 33.

### **Hetem (Zeqir) Selmani**

(20.08.1949, shqiptar nga Gllamniku/Glavnik, komuna e Podujevës/Podujevo, punëtor në TC Obiliq/Obilić, katër fëmijë)

### **Salih (Zeqir) Selmani**

(25.06.1951, shqiptar nga Gllamniku/Glavnik, komuna e Podujevës/Podujevo, arsimtar, tre fëmijë)

Vëllezërit Hetemi dhe Salihu e ndanin oborrin e përbashkët. Salihu punonte si arsimtar i gjuhës shqipe në shkollën fillore në Sfeqël/Svetlje. Në mëngjesin e datës **24.12.1998**, forcat serbe e vendosën rrethimin e **Gllamnikut/Glavnik** dhe filluan të bombardonin fshatin. UÇK-ja i mbante pozicionet përmbi fshat. Civilët, që gjendeshin nën breshërinë e predhave dhe të shtënave, filluan të largoheshin nga fshati. Salihu e çoi familjen jashtë fshatit dhe pastaj u kthye në shtëpi. Ndenji me të atin Zeqirin. Hetemi me bashkëshorten Hafizen, vajzën dhe djalin Besimin u nisën drejt fshatit Sekiraqë/Sekirača. I biri Gëzimi shkoi drejt pyllit, ku gjendej UÇK